

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Kthimi¹ / *el-Inaabeh* /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

“Kthejuni Zotit tuaj.” (ez-Zumer, 54)

Kthimi te Zoti ka tri pjesë:

- Kthimi tek Ai me një reformim të njëmendtë pasi t'i jesh kthyer Atij me kërkesë për falje.²
- Kthimi tek Ai me zbatim pasi t'i jesh kthyer Atij me premtim³

¹ Kjo është një fazë përbrenda fazave të pendimit (*teubes*) të singertë. Mirëpo, meqë për shumicën e njerëzve pendimi mund të mos nënkuptojë më shumë sesa një kërkesë faljeje dhe vendosmëri për të mos përsëritur shkeljen, është e domosdoshme të përshkruhet puna që besimtari e ka për detyrë, në mënyrë që ai të tregojë se vërtet po i kthehet i penduar Zotit. Fjala “*inaabeh*” përmendet në shumë ajete të Kuranit; nganjëherë në formë urdhërore, si në vijim: “Kthejuni (të penduar) Zotit tuaj dhe nënshtrojeni Atij para se t’ju vijë ndëshkimi atëherë kur s’do të ndihmoheni.” (ez-Zumer, 54)

Kemi dhe formën mbiemërore apo ndajfoljore, si p.sh.:

“Vërtet Ibrahim i qe i përmbajtur, që ndiente keqardhje, dhe i kthyeshëm (pendohej vazhdimisht).” (Hud, 75).

“Ata që ia kishin frikën Mëshirëplotit pa e parë Atë dhe i vinin me zemër të kthyeshme (të penduar).” (Kaaf, 33)

“Kur njerëzit i godet fatkeqësia, ata i luten Zotit të tyre duke iu kthyer Atij. Pastaj, kur Ai i lë ta shijojnë mëshirën e Tij, një pjesë e tyre pëmjëherë i vejnë ortakë Zotit të tyre.” (er-Rum, 33)

² Të thuash “më fal” nuk do të thotë së vërtet të vjen keq. Njeriut edhe mund t’i vijë keq, por dhe të dështojë të tregojë reformimin pasi të kërkojë falje.

³ Kur njeriu pendohet, (në të vërtetë) i zotohet Allahut. Dhe Allahu do t’i marrë në përgjegjësi njerëzit për zotimet e tyre. Allahu thotë:

- Kthimi tek Ai me gjendjen tënde (të brendshme) pasi t'i jesh përgjigjur thirrjes së Tij (me të jashtmen; me veprat e jashtme)⁴

Kthimi me një reformë të njëmendtë mund të arrihet nëpërmjet tri gjërave:

- Përmirësimi i pasojave (të gjynahut)⁵
- Dhimbja për hapat e gabuar⁶
- Kompensimi i asaj që ka humbur (është lënë pa bërë)⁷

Kthimi tek Ai me plotësim mund të arrihet nëpërmjet tri gjërave:

- Të ikësh nga kënaqësia e gjynaheve⁸
- Të përmbahesh nga të shikuarit me superioritet të shkujdesurit (gjynahqarët) dhe të kesh frikë për ta ndërsa shpreson shpëtimin për vetveten⁹

“Ata, që më parë, i patën premtuar Allahut se s’do ta kthenin shpinën dhe të iknin. Dhe për premtimin (zotimin) e dhënë Allahut do të ketë përgjegjësi.” (el-Ahzaab, 15)

⁴ Ibn el-Kajjim citoi el-Hasan el-Basrin duke thënë: “O biri i Ademit, ti flet dhe vepron, ndërsa veprimet e tua meritojnë më shumë vëmendje sesa e folura jote; dhe ti ke të brendshmen dhe të jashtmen, ndërsa e brendshmjia jote përcakton fatin tënd më shumë sesa e jashtmjia jote.”

Njeriu mund ta disiplinojë të jashtmen më shumë, gjë që është me rëndësi, por jo dhe e mjaftueshme. Shpëtimi i plotë do të arrihet atëherë kur vërtet ta pastrosh të brendshmen tënde.

⁵ Krahas keqardhjeve tua dhe kërkesës për falje, ti duhet t’ua kthesh njerëzve të drejtat që u takojnë dhe t’i ndreqësh gabimet që ke bërë apo ke shkaktuar.

⁶ Kjo mund të nënkuptojë hapat e tu të gabuar, por po ashtu tregon se njeriu që vërtet i kthehet me zemër Allahut, do të ketë një zemër të butë, që ua do të mirën të gjithë njerëzve dhe ndien dhembshuri për gabimet që i bëjnë ata.

⁷ Tash që je penduar, kompenso namazet dhe *dhikrin* që të ka ikur, si edhe kohën që ke çuar kot. Nëse ke qenë i ashpër me bashkëshortin / bashkëshorten apo me të afërmit, kompenso duke shtuar punët e mira, etj.

⁸ Kjo është kur tekat dhe dëshirat e tua janë në përputhje me ato të Allahut dhe me atë që ta solli i Dërguari i Tij. Pejgamberi ﷺ tha: “Asnjë prej jush nuk do të besojë përnjëmend, derisa dëshirat e tij t’i nënshtrohen plotësisht asaj çfarë kam sjell.” (Imam Newewi tha: “Këtë hadith, me zinxhir të vërtetë transmetuesish, e kemi përcjell në *Kitab el-Huxhxheh*.”)

⁹ Sepse më me vend është që më së shumti të kesh frikë për shpëtimin dhe sigurinë tënde, dhe të mos ndihesh tepër i sigurt për sinqeritetin e nijeteve tua.

- Të jesh gjithëpërfshirës (t'i shikosh të gjitha), kur shikon të metat e shërbimit (adhurimit) që ti ofron.

Kthimi tek Ai me të brendshmen tënde mund të arrihet nëpërmjet tri gjërave:

- Të dëshpërohesh nga veprat e tua¹⁰
- Të ndiesh varfërinë dhe nevojën tënde për Zotin
- Të shohësh butësinë dhe mëshirën e Tij ndaj teje¹¹

¹⁰ Kështu ti s'do t'i shohësh kurrë punët e tua si prova për vlerën tënde, sepse gjithmonë do të jesh i brengosur nëse ato janë pranuar dhe sa është pranuar prej tyre. Po edhe nëse pranohen, ato janë dhurata nga Ai.

¹¹ Në fund, pasi të jesh dëshpëruar nga punët e tua dhe nga vetvetja, ti sheh mëshirën e Tij gjithëpërfshirëse dhe mban shpresë se do të përfshihesh ndër ata të cilëve Ai do t'u dhurojë mëshirë.